




Funded by
the European Union



TRANSPARENCË DHE LLOGARIDHËNIE NË VLERËSIMIN BIO-PSIKO-SOCIAL: NGA GJETJET NË VEPRIM



TRANSPARENCË DHE LLOGARIDHËNIE NË VLERËSIMIN BIO-PSIKO-SOCIAL:
NGA GJETJET NË VEPRIM

SHTATOR 2025

Përmbajtja

1. Përmbledhje Ekzekutive.....	1
2. Qëllimi dhe objektivat e raportit.....	2
3. Kuadri Ligjor dhe Institucional.....	3
4. Metodologjia e Hulumtimit.....	4
5. Analiza e të Dhënave.....	6
<i>5.1 Përmbledhje Narrative e Analizës së Pyetësorit mbi Procesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për Personat me Aftësi të Kufizuar, nga prindërit, familjarët dhe anëtarët e komunitetit</i>	
.....	6
<i>5.2 Përmbledhje Narrative e Analizës së Pyetësorit mbi Procesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për Personat me Aftësi të Kufizuar, nga Anëtarët e Komisioneve dhe Specialistët në ZVA dhe Shkolla.....</i>	<i>8</i>
6. Gjetjet dhe rekomandimet.....	11
<i>6.1 Gjetjet dhe rekomandimet nga prindërit, familjarët dhe anëtarët e komunitetit.....</i>	<i>11</i>
<i>6.2 Gjetjet dhe rekomandimet nga Anëtarët e Komisioneve dhe Specialistët në ZVA dhe Shkolla.....</i>	<i>13</i>

1. Përmbledhje Ekzekutive

Procesi i vlerësimit bio-psiko-social për personat me aftësi të kufizuar ka për qëllim identifikimin e nevojave individuale dhe sigurimin e mbështetjes së duhur për ta, duke promovuar përfshirje, barazi dhe qasje gjithëpërfshirëse. Ky proces është në përputhje me Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, e cila garanton pjesëmarrje të plotë në shoqëri dhe qasje të barabartë në shërbime. Ai gjithashtu pasqyron qasjen e Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësive dhe Shëndetit (ICF), një standard të OBSH-së për përshkrimin e shëndetit dhe aftësive të individëve, duke marrë parasysh funksionimin fizik, psikologjik dhe social dhe duke ndihmuar në kuptimin e pabarazive, pengesave dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuar. Në nivel kombëtar, procesi respekton legjislacionin për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe për zhvillimin e shërbimeve sociale dhe edukative.

Në kuadër të këtij procesi, janë zhvilluar fokus-grupe me prindër, familjarë dhe profesionistë, ndërsa përf forcime të të dhënave janë siguruar edhe përmes intervistave individuale dhe pyetësorëve online. Këto të dhëna plotësojnë pamjen mbi përvojën reale të pjesëmarrësve dhe praktikave institucionale, pa u bërë theksi kryesor i metodologjisë.

Pjesëmarrësit në fokus-grupet e prindërve dhe komunitetit ishin kryesisht gra, të angazhuara në mbështetjen e personave me aftësi të kufizuar, me përfaqësim më të madh të moshës 36–55 vjeç. Roli i tyre ishte kryesisht ai i prindërve, ndërsa familjarët e tjerë dhe anëtarët e komunitetit kontribuan gjithashtu, duke ofruar një pasqyrë të plotë të sfidave dhe nevojave reale. Shpërndarja gjeografike e pjesëmarrësve tregoi një balancë midis zonave urbane dhe rurale, duke evidentuar nevojën për mbështetje të shtuar në zonat më të largëta ku aksesimi i shërbimeve është më i vështirë.

Përvoja e pjesëmarrësve tregon se shumica kanë marrë pjesë aktivisht në proces, por disa kanë mbetur jashtë për shkak të mungesës së informacionit ose vështirësive për t'u qasur në shërbime. Komisionet përbëheshin kryesisht nga mjekë, ndërsa prezenca e psikologëve dhe punonjësve social shpesh mungonte, duke çuar në vlerësime të pjesshme dhe shërbime jo të personalizuar. Vështirësitë më të shpeshta lidhen me procedura komplekse, vonesa dhe mungesë mbështetje emocionale. Shumë prindër ndihen të përjashtuar nga vendimmarrja, siç reflektohet në shprehjen e njërit prej tyre: *“Ata persona që janë caktuar vlerësues për atë rast duhet të vendosin veten në vendin e familjarit për të kuptuar peripecitë që ne kalojmë dhe jo të na shohin nga duart për t'u dhënë rryshfet.”*

Nga ana e profesionistëve dhe institucioneve, të dhënat tregojnë se procesi është multidisiplinor dhe përfshin kontribute nga shërbimet sociale, arsimi dhe shëndetësia, punonjës social, psikologë, mësues ndihmës dhe mjekë specialistë. Profesionistët e perceptojnë procesin si të domosdoshëm dhe efektiv, duke njohur rëndësinë e tij për identifikimin e nevojave individuale dhe planifikimin e ndërhyrjeve të duhura. Megjithatë, u evidentuan sfida në bashkëpunimin ndërinstitucional, përdorimin e protokolleve standarde dhe trajnimin e vazhdueshëm. Përdorimi i mjeteve të veçanta, si braille apo gjuha e shenjave, është i kufizuar, duke treguar nevojën për përmirësime në akses dhe aftësi profesionale.

Të dhënat e mbledhura nënvizojnë nevojën për komunikim të qartë dhe të thjeshtë, përfshirje aktive të familjeve, rritje të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësim të infrastrukturës dhe hapësirave të përshtatshme. Shumë pjesëmarrës shprehin pritshmëri që fëmijët e tyre të përfshihen barabartë në shoqëri dhe të marrin mbështetje të dobishme nga profesionistë të trajnuar dhe të përkushtuar. Siç thotë një prind: *“Shpresat janë që fëmija të fillojë të jetë si gjithë fëmijët e tjerë.”*

Në përgjithësi, vlerësimi bio-psiko-social konsiderohet një proces i domosdoshëm dhe i efektshëm, i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe zhvillimin profesional të stafit. Megjithatë, për të arritur një përfshirje dhe funksionim optimal, kërkohen trajnime të qëndrueshme, koordinim i përmirësuar ndërinstitucional, standardizim i praktikave, përdorim më i gjerë i mjeteve speciale dhe përshtatje të infrastrukturës.

2. Qëllimi dhe objektivat e raportit

Ky raport ka për qëllim të analizojë procesin e vlerësimit bio-psiko-social për personat me aftësi të kufizuar nga perspektiva e profesionistëve që angazhohen në këtë proces dhe nga ajo e prindërve dhe familjeve të tyre. Analiza synon të identifikojë sfidat, mangësitë dhe nevojat që shfaqen gjatë zhvillimit të vlerësimit, duke reflektuar përvojat reale të aktorëve kryesorë dhe duke nxjerrë në pah pengesat që ndikojnë në efektivitetin e procesit.

Raporti synon gjithashtu të ofrojë rekomandime konkrete për përmirësimin e procesit, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional, multidisiplinaritetit dhe qasjes gjithëpërfshirëse. Ai shërben si një bazë për standardizimin e praktikave, për avancimin e cilësisë së shërbimeve dhe për sigurimin e një mbështetjeje më efektive për personat me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre.

Në thelb, ky dokument synon të sigurojë një kuptim të qartë të nevojave të individëve dhe komuniteteve, të nxjerrë në pah përparësitë dhe dobësitë e sistemit aktual dhe të propozojë udhëzime për një proces vlerësimi më të drejtë, të aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës, në përputhje me Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe praktikatat ndërkombëtare të Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësive dhe Shëndetit (ICF)

3. Kuadri Ligjor dhe Institucional

Para vitit 2014, vlerësimi i aftësisë së kufizuar në Shqipëri kryhej kryesisht mbi baza mjekësore, përmes komisioneve të paaftësisë që fokusoheshin kryesisht tek diagnoza dhe dëmtimet fizike ose mendore. Ky proces ishte kryesisht klinik dhe nuk merrte parasysh dimensionet psikologjike dhe sociale të individit.

Gjatë periudhës 2014–2016, në kuadër të reformave të mbështetura nga organizata ndërkombëtare si UNICEF, Save the Children dhe OBSH, filloi konceptimi i një qasjeje më gjithëpërfshirëse bio-psiko-sociale. Kjo qasje u bazua në modelin e ICF-së (International Classification of Functioning, Disability and Health) të OBSH-së, që integron dimensionet funksionale, personale dhe mjedisore të individëve me aftësi të kufizuar. Qëllimi ishte të ofrohej një vlerësim më i plotë, që nuk kufizohej vetëm në diagnozën mjekësore, por që merrte parasysh gjithashtu aftësitë kognitive, gjendjen emocionale dhe pjesëmarrjen sociale.

Nga viti 2018 filloi pilotimi i skemës së re në disa bashki, duke testuar mekanizmat dhe strukturat e vlerësimit bio-psiko-social në nivel lokal. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 121/2020 "Për shërbimet sociale në Republikën e Shqipërisë", procesi u formalizua dhe u bë baza ligjore për të gjithë vlerësimin e personave me aftësi të kufizuar në vend. Që nga viti 2022 e në vazhdim, procesi është duke u zgjeruar gradualisht në nivel kombëtar, edhe pse mbulimi i plotë nuk është arritur ende. Sot, vlerësimi bio-psiko-social i aftësisë së kufizuar është një proces i strukturuar dhe i integruar, i mbështetur nga kuadri ligjor dhe institucional, që synon të sigurojë mbrojtje dhe mbështetje për individët me nevoja të veçanta.

Ky proces ligjor mbështetet në disa dokumente kryesore:

- **Ligji Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar"**, i cili ndryshoi qasjen ndaj aftësisë së kufizuar dhe vendosi bazat për vlerësimin funksional ndërdisiplinor.
- **VKM Nr. 244, datë 30.03.2022 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për vlerësimin bio-psiko-social"**, që rregullon strukturat, procedurat, përgjegjësitë dhe përbërjen shumëdisiplinore të komisioneve të vlerësimit.
- **Ligji Nr. 121/2020 "Për shërbimet sociale në Republikën e Shqipërisë"**, që përforcon lidhjen midis vlerësimit funksional dhe ofrimit të shërbimeve sociale në nivel vendor, duke garantuar funksionimin e komisioneve përmes strukturave qendrore dhe rajonale të ngritura nga Shërbimi Social Shtetëror.
- **Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar" (i ndryshuar)**, që sanksionon të drejtën për arsim të barabartë dhe gjithëpërfshirës, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuar.
- **Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar**, ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 108/2012, që përcakton standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.
- **Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë dhe Shëndetit (ICF) – OBSH**, si model mbi të cilin bazohet vlerësimi bio-psiko-social.

Ligji kryesor që rregullon procesin është Ligji Nr. 57/2019 "Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara", i cili hyri në fuqi në vitin 2020 dhe integron modelin bio-psiko-social. Ky ligj fokusohet në tre dimensionet kryesore: aspektet biologjike, që lidhen me shëndetin fizik dhe funksionimin e trupit; aspektet psikologjike, që lidhen me shëndetin mendor dhe aftësitë kognitive; dhe aspektet sociale, që lidhen me pjesëmarrjen në shoqëri dhe mbështetjen sociale. Ligji është i mbështetur gjithashtu nga aktet nënligjore dhe manualet përkatëse, duke marrë parasysh praktikën ndërkombëtare.

Procesi i vlerësimit realizohet nga një strukturë e decentralizuar që përfshin nivele qendrore dhe lokale. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe strategjive kombëtare, si dhe për miratimin e udhëzimeve dhe manualeve për vlerësimin bio-psiko-social. Shërbimi Social Shtetëror (SSS) koordinon dhe mbikëqyr procesin në nivel kombëtar, duke ofruar trajnime dhe mbështetje për profesionistët që realizojnë vlerësimin. Në nivel lokal, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) implementojnë procesin, duke siguruar shërbime dhe mbështetje sociale për individët me aftësi të kufizuar. Vlerësimin e kryejnë gjithashtu komisionet e vlerësimit, të cilat përbëhen nga specialistë të fushave të ndryshme, si mjekë, psikologë dhe punonjës socialë, të cilët përcaktojnë nevojat për mbështetje të individëve.

4. Metodologjia e Hulumtimit

Hulumtimi u zhvillua në shtatë bashki të Qarkut Elbasan, specifikisht në bashkitë: Elbasan, Librazhd, Prrrenjas, Peqin, Cërrik, Gramsh dhe Belsh. Zgjedhja e këtyre bashkive u bazua në përfaqësimin e komuniteteve urbane dhe rurale, si dhe në prani të strukturave shëndetësore, arsimore dhe sociale që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Kjo qasje siguroi një panoramë të gjerë dhe të larmishme të përvojave dhe sfidave që hasen në nivel lokal, duke lejuar një analizë krahasuese midis bashkive dhe grupeve të pjesëmarrësve.

Hulumtimi kishte karakter analizues, përmbledhës dhe krahasues, duke u fokusuar tek perceptimet dhe përvojat e dy grupeve kryesore: profesionistëve që punojnë në institucione shëndetësore, arsimore dhe sociale, dhe prindërve/familjeve të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi kryesor ishte të identifikohen sfidat, nevojat dhe pritshmëritë e secilit grup, si dhe të nxirren përfundime gjithëpërfshirëse mbi procesin e vlerësimit bio-psiko-social.

Për mbledhjen e të dhënave u përdor një kombinim metodash të ndryshme, që mundësojnë kapjen e informacionit të detajuar dhe të bazuar në përvojë. Fokus-grupet dhe intervistat me profesionistë ndihmuan në identifikimin e praktikave institucionale, sfidave të përditshme dhe nevojave për përmirësim në procesin e vlerësimit. Fokus-grupet dhe intervistat me prindër dhe familjarë u përdorën për të kuptuar përvojën e tyre personale, pritshmëritë dhe perceptimet mbi efektivitetin dhe mbulimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara. Për të strukturuar informacionin dhe për të lehtësuar krahasimin mes grupeve dhe bashkive, u përdorën gjithashtu pyetësorë të strukturuar, që evidentuan përvojat, sfidat dhe pritshmëritë e pjesëmarrësve në mënyrë të sistemuara.

Pyetjet e fokus-grupeve përfshinin pyetje të hapura dhe të mbyllura, të cilat u organizuan në katër seksione kryesore. Seksioni I përqendrohej tek informacioni demografik dhe profili i pjesëmarrësve, duke përfshirë të dhëna mbi moshën, gjininë, vendbanimin dhe përkatësinë institucionale ose familjare. Seksioni II trajtonte përvojën e pjesëmarrësve me procesin e vlerësimit bio-psiko-social, duke evidentuar perceptimet mbi efektivitetin dhe qasjen e përdorur. Seksioni III u fokusua në aspektet e bashkëpunimit dhe komunikimit midis institucioneve, profesionistëve dhe familjeve, ndërsa Seksioni IV synonte të evidentonte sfidat dhe mundësitë, duke nxjerrë në pah nevojat për përmirësim dhe potencialin për zhvillime të mëtejshme në këtë proces.

Analiza e të dhënave u zhvillua përmes krahasimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të secilit grup pjesëmarrës. Kjo qasje mundësoi identifikimin e pikave të përbashkëta, ku perceptimet e profesionistëve dhe prindërve/familjeve përputheshin, si dhe evidentimin e diferencave, që ndihmuan në kuptimin e perspektivave specifike të secilit grup. Bazuar në këto të dhëna, u nxorrën përfundime gjithëpërfshirëse, që synojnë të përmirësojnë praktikën e vlerësimit bio-psiko-social, të rrisin bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe familjeve, dhe të orientojnë politika dhe shërbime më efektive në nivel lokal dhe kombëtar.

5. Analiza e të Dhënave

5.1 Përmbledhje Narrative e Analizës së Pyetësorit mbi Procesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për Personat me Aftësi të Kufizuara, nga prindërit, familjarët dhe anëtarët e komunitetit

Pjesëmarrësit ishin kryesisht femra (68%), duke reflektuar rolin më aktiv të grave në kujdesin dhe mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, ndërsa meshkujt përbënin 32%. Sa i përket moshës, grupi më i madh ishte ai 36–45 vjeç (40%), i ndjekur nga grupmosha 46–55 vjeç (28%) dhe 26–35 vjeç (16%), ndërsa përfaqësimi më i ulët ishte tek të rinjtë 18–25 vjeç (4%) dhe tek mbi 55 vjeç (8%).

Roli kryesor i pjesëmarrësve ishte ai i prindërve të personave me aftësi të kufizuara (rreth 80% në total, përfshirë prindër dhe prindër fëmijësh), ndërsa familjarët e tjerë dhe anëtarët e komunitetit përbënin nga 8% secili.

Sa i përket zonës së banimit, pjesëmarrësit ishin pothuajse të balancuar mes zonave urbane (52%) dhe atyre rurale (48%), çka siguron një pasqyrë gjithëpërfshirëse, por njëkohësisht nënvizon nevojën për më shumë mbështetje në zonat rurale ku sfidat e aksesit në shërbime dhe informacion janë më të theksuara.

Analiza e përvojës së pjesëmarrësve me procesin e vlerësimit bio-psiko-social tregon se shumica dërrmuese kanë qenë pjesëmarrës aktivë, duke përjetuar drejtpërdrejt procedurat për fëmijët ose të afërmit me aftësi të kufizuara, ndërsa një pakicë mbetet jashtë procesit, kryesisht për shkak të mungesës së informacionit ose vështirësive për të aksesuar shërbimet. Komisionet e vlerësimit përbëhen kryesisht nga mjekët, dhe përfshirja e psikologëve dhe punonjësve socialë është shpesh e pamjaftueshme, gjë që çon në vlerësime të pjesshme dhe shërbime jo të personalizuar. Shumica e pjesëmarrësve e perceptojnë ekipin profesional si të mirë, por mungesa e përbërjes multidisciplinare tregon nevojën për përmirësim në koordinim dhe monitorim të vazhdueshëm.

Ndërkohë, pjesëmarrësit identifikojnë vështirësi të shumta gjatë procesit, kryesisht mungesën e informacionit, procedurat e ndërlikuara, vonesat dhe mungesën e mbështetjes emocionale. Rreth 70% ndihen të përjashtuar nga vendimmarrja dhe se zëri i tyre nuk merret parasysh, duke reflektuar nevojën për mekanizma më efektivë për përfshirje aktive. Pakica ka marrë ndihmë direkte nga profesionistët, ndërsa shumica duhet të përballen me procesin pa mbështetje profesionale.

Pritshmëritë e pjesëmarrësve lidhen kryesisht me identifikimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara dhe sigurimin e mbështetjes konkrete për ta, duke e parë procesin si një instrument të domosdoshëm për njohjen e situatës dhe lidhjen me shërbimet përkatëse. Përvoja e tyre shpesh është e përzier: disa ndihen të kënaqur me angazhimin e stafit dhe qasjen institucionale, ndërsa një pjesë tjetër përjeton stres, lodhje dhe zhgënjim për shkak të vonesave, komunikimit joefikas dhe mungesës së transparencës.

Aspektet që hasin më shumë vështirësi janë pjesët psikologjike dhe sociale të vlerësimit, kryesisht për shkak të mungesës së prezencës së psikologut dhe punonjësit social në familje, si dhe terminologjia mjekësore e paqartë. Shumica e pjesëmarrësve nuk kanë ndjekur trajnime specifike për procesin dhe raportojnë mungesë të mjeteve ose gjuhës së përshtatur gjatë vlerësimit. Po ashtu, mungesa e infrastrukturës dhe mjediseve të përshtatshme për zhvillimin e vlerësimeve tregon një pengesë të dukshme për realizimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe profesional.

Në përgjithësi, procesi perceptohet si i nevojshëm dhe përmban elemente të dobishme, por kërkon përmirësime të qarta në komunikim, përfshirje aktive, trajnime profesionale, transparencë dhe adaptim të infrastrukturës për të garantuar një përvojë gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe funksionale për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

Ky seksion analizon nivelin dhe cilësinë e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet institucioneve, komisioneve dhe familjeve, duke evidentuar sfidat në kuptueshmërinë e vlerësimit bio-psiko-social dhe duke nxjerrë rekomandime për përmirësimin e bashkëpunimit dhe qasjes gjithëpërfshirëse ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Analiza e përgjigjeve tregon se bashkëpunimi ndërinstitutional për realizimin e vlerësimeve bio-psiko-sociale është ende i kufizuar, me vetëm 21% të pjesëmarrësve që raportojnë bashkëpunim të plotë, 25% pjesërisht, dhe 54% pa bashkëpunim fare. Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara është i përzjerë: 38% e vlerësuan si të mirë, 21% të dobët dhe 42% pa asnjë komunikim të dukshëm. Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike dhe OJQ-ve shihet si relativisht efektiv nga 46% e pjesëmarrësve, por 25% e konsideruan “pak efektiv” dhe 8% “jo efektiv”.

Përsa i përket bashkëpunimit me institucionet dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit, perceptimet janë të përziera dhe shpesh negative, ku vetëm 20–25% raportuan bashkëpunim të mirë, ndërsa 30–35% e panë si të dobët ose aspak bashkëpunues (3.4). Rreth 35–40% e pjesëmarrësve ndihen të ndihmuar nga komisionet për të kuptuar vlerësimin në mënyrë gjithëpërfshirëse, por 20–25% raportuan mungesë totale të ndihmës.

Sa i përket qartësisë së vlerësimit, vetëm 25–30% e pjesëmarrësve e konsideruan procesin “të qartë” ose “shumë të qartë”, ndërsa 35–40% raportuan kuptim të pjesshëm dhe 25% konfuzion të plotë. Përmirësimi i komunikimit me prindërit/personat me aftësi të kufizuara dhe institucionet e tjera mund të arrihet përmes bashkëpunimit të ngushtë me profesionistët, takimeve të shpeshta, ndarjes së informacionit në kohë, afrimitetit, empatisë dhe trajnimeve për familjet. Një pjesëmarrës theksoi: *“Ata persona që janë caktuar vlerësues për atë rast duhet të vendosin veten në vendin e familjarit për të kuptuar peripecitë që ne kalojmë dhe jo të na shohin nga duart për t’u dhënë rryshfet.”*

Në përgjithësi, të dhënat nënvizojnë nevojën për forcimin e mekanizmave të bashkëpunimit, koordinimit dhe komunikimit të qartë ndërinstitutional për të siguruar shërbime gjithëpërfshirëse për personat me aftësi të kufizuara.

Prindërit e personave me aftësi të kufizuara dhe anëtarët e komunitetit që i mbështesin ata theksojnë nevojën për përmirësime të dukshme në procesin e vlerësimit bio-psiko-social. Ata kërkojnë informim të qartë dhe të thjeshtë, përdorim të termave të kuptueshëm, shmangie të zvarritjes së panevojshme dhe një bashkëpunim më të ngushtë me prindërit dhe fëmijët. Një pjesë e konsiderueshme thekson mungesën e profesionistëve të specializuar, duke sugjeruar përfshirjen e psikologëve, logopedëve dhe ekspertëve të fushave të ndryshme, si dhe një komision më profesional dhe gjithëpërfshirës.

Për të përmirësuar përfshirjen e familjeve, prindërit sugjerojnë komunikim të rregullt dhe informim mbi gjendjen dhe progresin e fëmijës, aktivitete që matin ndryshimet tek fëmijët, trajnime për prindërit dhe fëmijët, si dhe hapësira më miqësore dhe të përshtatshme për zhvillimin e fëmijëve. Në lidhje me mbështetjen gjatë dhe pas vlerësimit, prindërit kërkojnë informacion të detajuar mbi progresin, udhëzime praktike për shërbimet dhe procedura të thjeshta dhe të kuptueshme, si dhe mbështetje emocionale dhe psikologjike. Ata theksojnë gjithashtu nevojën për më shumë seriozitet, transparencë dhe shoqërim të vazhdueshëm nga profesionistët.

Prindërit dhe komuniteti vlerësojnë se duhet të përfshihen më shumë institucione dhe profesionistë të specializuar, përfshirë logopedë, psikologë, mjekë specialistë, qendra terapi dhe shërbime sociale, si dhe bashkia. Kritikë të forta shkojnë ndaj komisioneve të vlerësimit që marrin vendime të shpejta pa shpjegime dhe pa marrë parasysh realitetin e fëmijës:

"Komisioni i vlerësimit doli për 5 minuta dhe dha konkluzione, pa shpjeguar asgjë dhe pa marrë parasysh realitetin e fëmijës tonë."

Sa i përket komunikimit të informacionit, shumica preferojnë takime ballë për ballë, që ofrojnë mundësi për pyetje dhe sqarime, ndërsa një pjesë më e vogël sheh të dobishme edhe broshurat ose shpjegimet me shkrim si material mbështetës.

Prindërit dërgojnë mesazhe të qarta për institucionet: shtim të stafit dhe shërbimeve, profesionalizim dhe trajnime për personelin, përmirësim të infrastrukturës dhe komunikimit, dhe bashkëpunim më të ngushtë me arsimin dhe profesionistët.

"Trajnimi i stafit që bën vlerësimet dhe procedura më të lehta për prindërit ose kujdestarët."

Në fund, shpresat dhe pritshmëritë e familjeve lidhen me përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, qartësinë dhe afërsinë e tyre, si dhe mbështetje më të madhe për fëmijët dhe familjet. Ata dëshirojnë që fëmijët të zhvillohen normalisht, të përfshihen më barabartë në shoqëri dhe të marrin shërbime të dobishme nga profesionistë të trajnuar dhe të përkushtuar:

"Shpresat janë që fëmija të fillojë të jetë si gjithë fëmijët e tjerë", "Te arsimohen e punësohen."
(bashkëngjitur shtojca me detajet e raportit)

5.2 Përmbledhje Narrative e Analizës së Pyetësorit mbi Procesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për Personat me Aftësi të Kufizuar, nga Anëtarët e Komisioneve dhe Specialistët në ZVA dhe Shkolla

Kjo përmbledhje paraqet analizën e të dhënave të mbledhura nga anëtarët e komisioneve të vlerësimit bio-psiko-social dhe specialistët në ZVA dhe shkolla, duke identifikuar sfidat kryesore në procesin e vlerësimit, si dhe rekomandimet praktike për përmirësimin e tij. Qëllimi është të sigurohet një proces gjithëpërfshirës, i aksesueshëm dhe efektiv për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, duke forcuar koordinimin ndërinstitutional dhe bashkëpunimin me komunitetet dhe familjet

Analiza e të dhënave nga fokus grupet tregon një përfaqësim të lartë të femrave, të cilat përbëjnë rreth 88% të pjesëmarrësve, ndërsa meshkujt përfaqësojnë rreth 12%.

Shpërndarja gjeografike e pjesëmarrësve tregon se më shumë të angazhuar janë nga Përrenjas dhe Librazhdi, pasuar nga Cërriku, ndërsa pjesëmarrësit nga Gramshi, Belshi, Elbasani dhe Peqini janë më të pakët.

Sipas sektorëve përgjegjës për procesin e vlerësimit bio-psiko-social për personat me aftësi të kufizuar, Shërbimet Sociale kanë pjesëmarrjen më të madhe, të ndjekura nga Edukimi dhe më pas Shëndetësia. Kjo tregon se procesi i vlerësimit është multidisiplinor, duke përfshirë ekspertizën sociale, edukative dhe mjekësore për një vlerësim gjithëpërfshirës.

Analiza e roleve të pjesëmarrësve konfirmon këtë multidisciplinaritet: punonjësit social përbëjnë grupin më të madh, ndërsa psikologët dhe mësuesit ndihmës kontribuojnë në aspektin psikologjik dhe edukativ të procesit. Roli i mjekëve, edhe pse më i vogël, është thelbësor për aspektin mjekësor, ndërsa drejtuesit dhe kryetarët e KMD mbajnë funksionin menaxherial dhe koordinues.

Sa i përket aksesueshmërisë, shumica e institucioneve raportohen si të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar, ndërkohë që një pjesë janë vetëm pjesërisht aksesueshëm, duke evidentuar nevojën për përmirësime infrastrukturore dhe adaptime të mëtejshme.

Përsa i përket punësimit të personave me aftësi të kufizuar, rreth 75% e pjesëmarrësve raportuan se institucionet e tyre nuk kanë të punësuar të tillë, ndërsa vetëm rreth 25% e institucioneve kanë përfshirë në staf persona me aftësi të kufizuar, duke treguar se përfshirja në punësim mbetet ende një sfidë për shumë institucione.

Shumica e profesionistëve që marrin pjesë në vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara kanë përvojë 1-6 vjet në këtë fushë, ndërsa një pjesë më e vogël ka mbi 10 vjet, duke treguar një kombinim të stafit të ri dhe atij me përvojë të gjatë. Të gjithë pjesëmarrësit e fokus grupeve e konsiderojnë procesin e vlerësimit bio-psiko-social si të domosdoshëm, duke e parë atë jo vetëm si një detyrë administrative, por si një mjet thelbësor për identifikimin e nevojave individuale dhe planifikimin e ndërhyrjeve të duhura.

Shumica e profesionistëve ndihen të përfshirë në proces, dhe përvoja e tyre është kryesisht pozitive, ku procesi shihet si sfidues, por edhe si një mundësi për të kontribuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe për të njohur progresin dhe nevojat e individëve.

Bashkëpunimi ndërinstitutional dhe multidisiplinor konsiderohet thelbësor për një vlerësim efektiv. Sistemi aktual i vlerësimit shihet si efektiv në nivel të pranueshëm, por ka ende nevojë për përmirësime strukturore, koordinim më të mirë dhe trajnime të vazhdueshme për profesionistët.

Aftësitë më të rëndësishme për një vlerësim të plotë përfshijnë njohuritë mbi shëndetin fizik dhe mendor, përdorimin e mjeteve të standardizuara, komunikimin me individin dhe koordinimin ndërdisiplinor, ndërsa pjesa psikologjike dhe sociale e vlerësimit shihet si më sfiduese për shkak të nevojës për ekspertizë të specializuar dhe mungesës së shërbimeve të integruara.

Trajnimi i specializuar mungon për një pjesë të konsiderueshme të profesionistëve, duke evidentuar nevojën për programe të qëndrueshme dhe të vazhdueshme trajnimi, përfshirë praktikë, mentorim dhe bashkëpunim ndërdisiplinor.

Mjediset dhe infrastruktura për zhvillimin e vlerësimeve janë të ndryshme, dhe përdorimi i mjeteve speciale dhe gjuhëve të veçanta (braille, gjuha e trupit, gjuha e shenjave) shpesh është i kufizuar, duke treguar nevojën për përmirësim të aksesueshmërisë dhe trajnimit të profesionistëve.

Profesionistët vlerësojnë më së shumti njohjen e nevojave individuale të fëmijës, bashkëpunimin me prindërit dhe aktorët e tjerë, përdorimin e metodave standardizuara, empatinë dhe qasjen gjithëpërfshirëse, si dhe mjedisin e përshtatshëm dhe ndjekjen pas vlerësimit.

Trajnimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi i aftësive praktike janë të domosdoshme për të siguruar një vlerësim gjithëpërfshirës, të saktë dhe efektiv, që kontribuon në zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Bashkëpunimi ndërinstitutional mes shëndetësisë, arsimit dhe punësimit ekziston në shumicën e rasteve, por ka ende mangësi koordinimi dhe pjesëmarrjeje të barabartë. Komunikimi me institucionet e tjera perceptohet kryesisht si efektiv, ndërsa bashkëpunimi me OJQ-të për mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara shihet si pozitiv, me hapësirë për përmirësim.

Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre është e pranishme në një nivel të mirë, megjithatë nuk është gjithmonë e plotë, duke lënë hapësira për standardizim dhe pjesëmarrje të vazhdueshme. Komunikimi dhe bashkëpunimi me prindërit vlerësohet kryesisht pozitiv, por sfidat kryesore lidhen me nivelin e arsimimit, mungesën e informacionit dhe vështirësitë në pranimin e situatës së fëmijës.

Për të përmirësuar komunikimin, praktikat më të mira përfshijnë përdorimin e gjuhës së thjeshtë, takime dhe trajnime të rregullta, këshillim, psikoedukim dhe empati nga stafi. Bashkëpunimi i vazhdueshëm, dëgjimi aktiv, dokumentimi i bisedave dhe përfshirja e prindërve në çdo fazë të procesit janë thelbësore për krijimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme dhe efektive.

Për përfshirjen më të madhe të personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve, rekomandohet siguria e informimit të qartë, përdorimi i metodave të përshtatura të komunikimit, aktivitetet praktike, grupet mbështetëse, trajnime të shpeshta dhe përfshirja në hartimin e planeve individuale (PEI). Krijimi i një ambienti besueshëm dhe mbështetës nxit bashkëpunimin, vetë-advokimin dhe bën që vlerësimi të jetë më gjithëpërfshirës dhe efektiv.

Në tërësi, gjetjet tregojnë një bazë pozitive bashkëpunimi dhe përfshirjeje, por evidentojnë nevojën për përmirësim në koordinim, komunikim të qartë dhe angazhim të vazhdueshëm të të gjithë aktorëve.

Analiza e të dhënave tregon se përdorimi i një qasjeje bio-psiko-sociale konsiderohet gjerësisht shumë i dobishëm për përmirësimin e shërbimeve dhe mundësive për personat me aftësi të kufizuara. Profesionistët theksojnë se kjo qasje ofron një pasqyrë të plotë mbi nevojat fizike, psikologjike dhe sociale të individit, duke lehtësuar përcaktimin e shërbimeve më të përshtatshme

dhe krijimin e planeve individuale të mbështetjes, të cilat nxisin përfshirjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve. Gjithashtu, qasja bio-psiko-sociale mundëson identifikimin e sfidave në arsim, shëndetësi dhe fushën sociale, duke stimuluar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe promovuar aftësi të pavarura tek individët.

Megjithatë, profesionistët evidentuan sfida të shumta që pengojnë efektivitetin e procesit, përfshirë mungesën e mbështetjes nga institucionet, kohën e gjatë për përfundimin e vlerësimeve, komunikimin joefektiv me prindërit, mungesën e informacionit dhe infrastrukturës së përshtatshme, si dhe resurseve materiale dhe njerëzore të pamjaftueshme. Mungesa e mjekëve specialistë, stafit të trajnuar dhe pajisjeve të nevojshme, si dhe problemet logjistike dhe burokratike, ndikojnë në cilësinë e shërbimeve.

Profesionistët theksuan gjithashtu nevojën për trajnime të vazhdueshme, shkëmbim eksperiencash, përdorim të mjeteve dhe instrumenteve standarde, si dhe përfshirje më aktive të familjes dhe komunitetit në proces. Sipas tyre, përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, përdorimi i teknologjisë dhe platformave dixhitale, si dhe rritja e mbështetjes financiare dhe materiale, janë elementë kyç për një proces gjithëpërfshirës dhe të efektshëm.

Në aspektin ligjor dhe rregullator, nevojitet përmirësimi i zbatimit praktik, vendosja e fondeve të qëndrueshme dhe specifikimi i detyrimeve të institucioneve dhe prindërve, për të siguruar shërbime cilësore dhe trajtim të drejtë për individët. Profesionistët sugjerojnë gjithashtu standardizimin e procedurave, planifikimin e individualizuar (PEI), monitorimin e vazhdueshëm dhe përdorimin e metodave gjithëpërfshirëse për të garantuar që çdo individ trajtohet me respekt dhe në përputhje me nevojat e tij specifike.

Mesazhi kryesor për prindërit është të jenë aktivë, të bashkëpunojnë me ekipin e vlerësimit, të ndjekin rekomandimet dhe të mbështesin fëmijët në aktivitete edukative dhe përditshme. Bashkëpunimi, durimi dhe përkushtimi i prindërve, stafit dhe komunitetit konsiderohen elementë kyç për zhvillimin, mirëqenien dhe përfshirjen dinjitoze të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

“Një proces gjithëpërfshirës, i ndjeshëm dhe i koordinuar mund të ndryshojë rrjedhën e jetës së një fëmije me aftësi të kufizuara.”

Në përmbledhje, profesionistët nënvizojnë se një kombinim i mbështetjes financiare, trajnimeve, instrumenteve të përmirësuara, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe angazhimit të familjes dhe komunitetit është çelësi për një vlerësim bio-psiko-social efektiv dhe gjithëpërfshirës.

6. Gjetjet dhe rekomandimet

6.1 Gjetjet dhe rekomandimet nga prindërit, familja dhe anëtarët e komunitetit

Hulumtimi tregoi se përgjegjësia kryesore për **kujdesin dhe ndjekjen e procesit të vlerësimit bio-psiko-social bie kryesisht mbi nënat**, të cilat shpesh përballen me barrën e plotë të përgjegjësi pa mbështetje të barabartë nga pjesëtarët e tjerë të familjes. Kjo situatë shkakton lodhje fizike dhe emocionale dhe ndikon në përfshirjen e tyre aktive në procese të tjera edukative dhe shoqërore. Prindërit **sugjerojnë** që duhet të promovohen mekanizma për ndarje më të drejtë të përgjegjësi

brenda familjes dhe të ofrohet mbështetje praktike dhe sociale përmes shërbimeve komunitare, që të lehtësohet roli i tyre në kujdesin e përditshëm dhe koordinimin me institucionet.

Një tjetër sfidë e evidentuar nga prindërit është ***mungesa e transparencës dhe informacionit të qartë***. Shumë prindër ndihen të pasigurt për procedurat dhe vendimmarrjen gjatë procesit të vlerësimit, duke u përballur me informacione të fragmentuara ose të paqarta nga institucionet përkatëse. Kjo mungesë informacioni shkakton shqetësime, pasiguri dhe shpesh vonesa në marrjen e shërbimeve të nevojshme. Për këtë arsye, ata ***rekomandojnë*** që institucionet të sigurojnë komunikim të qartë dhe të vazhdueshëm, të përgatisin udhëzime të shkruara dhe ilustrative dhe të ofrojnë shpjegime praktike dhe interaktive për çdo hap të procesit, në mënyrë që familjet të kuptojnë plotësisht procedurat dhe të ndihen të përfshira në vendimmarrje.

Prindërit raportuan gjithashtu ***një ngarkesë të madhe emocionale dhe sociale***, e shprehur në formën e stresit të përditshëm, ndjenjës së izolimit dhe stigmatizimit në komunitet. Shpesh familjet përballen me vështirësi në integrimin social të fëmijëve të tyre dhe ndihen të vetmuar në përpyekjet për të siguruar kujdes adekuat. Për t'u adresuar këto sfida, ata ***sugjerojnë*** ofrimin e mbështetjes psikologjike të specializuar, krijimin e grupeve mbështetëse për familjet, si dhe zhvillimin e programeve të ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit për komunitetin, që të reduktohet stigma dhe të forcohet mbështetja sociale për individët dhe familjet.

Një sfidë tjetër e madhe e identifikuar nga prindërit është ***vështirësia financiare***, e shkaktuar nga mungesa e ndihmave të mjaftueshme, kostot e larta për shërbimet shëndetësore, transportin dhe pajisjet ndihmëse. Kjo situatë kufizon mundësitë e përfshirjes së fëmijëve në aktivitete arsimore dhe sociale dhe rrit pabarazitë midis familjeve që kanë burime të ndryshme ekonomike. Prindërit ***rekomandojnë*** ndërtimin e skemave financiare mbështetëse, ofrimin e subvencioneve për shërbimet dhe transportin, si dhe një mbështetje afatgjatë për familjet në nevojë, në mënyrë që të sigurohet qasje e barabartë dhe të zbuten pengesat ekonomike që ndikojnë në përfshirjen dhe zhvillimin e fëmijëve.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, shumë familje përballen me ***mungesë shërbimesh të qëndrueshme dhe mbështetje të vazhdueshme***, duke bërë që investimi në procesin e vlerësimit të mos shfrytëzohet plotësisht. Për këtë arsye, prindërit ***rekomandojnë*** krijimin e qendrave të shërbimeve të qëndrueshme, përfshirë edhe shërbime lëvizëse që mund të arrijnë familjet në zona më të largëta, ofrimin e mbështetjes pas vlerësimit, si dhe koordinimin e vazhdueshëm ndërinstitutional, që të sigurohet monitorim, ndjekje individuale dhe përfshirje e vazhdueshme e familjeve dhe përfituesve në trajtimin e nevojave të tyre.

Së fundi, ***burokracia dhe procedurat e ndërlikuara*** paraqesin një pengesë të konsiderueshme për prindërit dhe ndikojnë në kohën e pritjes dhe përsëritjen e dokumenteve, duke rritur stresin dhe vështirësinë për të përfituar shërbime në kohë. Si zgjidhje, ata ***rekomandojnë*** thjeshtezimin e procedurave, shkurtimin e afateve të pritjes, si dhe digjitalizimin e pjesës më të madhe të procesit, duke e bërë procesin më të aksesueshëm dhe më të lehtë për familjet.

6.2 Gjetjet dhe rekomandimet nga Anëtarët e Komisioneve dhe Specialistët në ZVA dhe Shkolla

Në kuadër të hulumtimit, një vëmendje e veçantë iu kushtua perceptimeve dhe përvojave të anëtarëve të komisioneve të vlerësimit bio-psiko-social dhe specialistëve që punojnë në Zyrat Vendore Arsimore (ZVA) dhe shkolla. Ky grup përbën aktorë kyç në procesin e vlerësimit dhe ofrimit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, duke pasur një njohuri të drejtpërdrejtë mbi sfidat, nevojat dhe mundësitë për përmirësim.

Përmbledhja e mëposhtme reflekton sfidat kryesore që ata hasin në punën e tyre të përditshme dhe rekomandimet konkrete që ata propozojnë për të përmirësuar procesin e vlerësimit, bashkëpunimin ndërinstitucional, kapacitetet profesionale, infrastrukturën dhe mbështetjen e përfituesve. Qëllimi është të ofrohet një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe të identifikohen masa praktike që mund të ndërmerren nga institucionet dhe profesionistët për të rritur efektivitetin dhe cilësinë e shërbimeve.

Kapacitetet njerëzore: Një sfida e rëndësishme identifikuar është mungesa e trajnimëve të strukturuar për profesionistët që kryejnë vlerësimin bio-psiko-social. Stafi shpesh ka përvojë të kufizuar, sidomos në aspektet psikologjike dhe sociale të procesit, duke bërë që trajtimi i nevojave të individëve të jetë jo gjithmonë i plotë. **Rekomandohet** zhvillimi i programeve të qëndrueshme trajnimi, përfshirja e mentorimit praktik, përdorimi i mjeteve të standardizuara të vlerësimit, dhe organizimi i shkëmbimeve të eksperiencave midis profesionistëve. Këto veprime janë të drejtuara kryesisht profesionistëve dhe institucioneve që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, për të rritur aftësitë dhe siguruar një qasje gjithëpërfshirëse.

Infrastruktura dhe aksesueshmëria: Studimi tregoi se 32% e institucioneve janë pjesërisht të aksesueshme, ndërsa 19% nuk janë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara. **Rekomandohet** realizimi i investimeve për përmirësimin e ambienteve, pajisjeve dhe mjeteve ndihmëse, duke përfshirë përdorimin e gjuhës së shenjave, braille-it dhe mjeteve të tjera ndihmëse. Kjo është e drejtuar te njësitë vendore dhe institucionet publike, që ofrojnë shërbime për komunitetin.

Bashkëpunimi ndërinstitucional: Hulumtimi evidentoi një koordinim të pamjaftueshëm mes sektorëve të shëndetësisë, arsimit dhe punësimit, si dhe burokraci në shkëmbimin e informacionit. **Rekomandohet:** Përmirësimi kërkon krijimin e protokolleve të qarta bashkëpunimi, organizimin e takimeve periodike ndërinstitucionale, dhe zhvillimin e planeve të përbashkëta individuale (PEI). Kjo adreson nevojat e institucioneve dhe profesionistëve që punojnë me personat me aftësi të kufizuara.

Ligji dhe politikat: Një tjetër sfida lidhet me zbatimin e pjesshëm të rregulloreve dhe mbështetjen financiare jo të qëndrueshme. **Rekomandohet** harmonizimi i legjislacionit me praktikatat europiane, sigurimi i një financimi të qëndrueshëm dhe vendosja e mekanizmave efektivë të monitorimit. Kjo është e drejtuar kryesisht institucioneve qendrore dhe lokale, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe ligjeve.

Teknologjia: Një sfidë e identifikuar është mungesa e platformave dixhitale dhe trajnimeve për përdorimin e tyre, si dhe nivel i ndryshëm i njohurive teknologjike të profesionistëve. **Rekomandohet** krijimi i platformave dixhitale për vlerësim, zhvillimi i trajnimeve për përdorimin e teknologjisë dhe përdorimi i interpretimit të specializuar për të siguruar qasje më të lehtë dhe efektive në procesin e vlerësimit. Kjo i drejtohet profesionistëve dhe institucioneve që ofrojnë shërbime të specializuara.

Mbështetja pas vlerësimit: Hulumtimi tregoi se shërbimet janë shpesh fragmentare dhe mungojnë rrjetet mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara. **Rekomandohet** krijimi i qendrave dhe shërbimeve pranë vendbanimeve, sigurimi i mbështetjes psikologjike, orientimi drejt punësimit, si dhe ndjekja individuale e përfituesve. Kjo synon të ofrojë një sistem mbështetës gjithëpërfshirës, të qëndrueshëm dhe të aksesueshëm për të gjithë përfituesit dhe familjet e tyre.

7. Literatura e Shfrytëzuar

Shërbimi Social Shtetëror. (2019). *Udhëzim për metodologjinë e kontrollit të vlerësimit bio-psiko-social*. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ligji Nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).

Manual për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar për të rriturit. Organizata Shqiptare e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Shëndetësor.

Manual për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar për fëmijët. Organizata Shqiptare e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Shëndetësor

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2021). *Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025*.

World Health Organization. (2001). *International Classification of Functioning, Disability and Health (ICF)*. Geneva: WHO.

UNICEF. (2018). *Guidance on conducting child functioning assessments and disability identification*. New York, NY: UNICEF.

Council of Europe. (2017). *Standards for inclusive education and early identification of support needs*. Strasbourg, France: Council of Europe.

American Psychiatric Association. (2013). *Diagnostic and statistical manual of mental disorders* (5th ed.). Arlington, VA: American Psychiatric Publishing.

8. Shtojcat



Analiza_FG_Prinderit&
Komuniteti.pdf



Analiza_FG_Profesion
iste.pdf